

## SHTOJCA I

### **Raporti për analizën e tregut dhe përcaktimi i operatorëve ne fuqi të ndjeshme në treg – Terminimi i thirrjeve me zë në rrjetet individuale mobile**

ARKEP me Vendimin nr.644, datë 27/05/2015, miratoi fillimin e procesit të analizës së terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale.

Në kuadër të këtij procesi përkatësisht implementimin e detyrimit për kontrollin e çmimeve, ARKEP duhet të përcaktoj modelin e llogaritjes e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale.

Sipas nenit 40 *“Autoriteti mund t’ua imponojë ndërmarrësve që kanë FNT në një treg relevant detyrime për mbulimin e kostos dhe kontrollimin e çmimit, duke përfshirë detyrimet për çmimet e bazuara në kosto dhe detyrimet lidhur me sistemet e llogaritjes së kostos, për ofrimin e llojeve specifike të interkoneksionit dhe/ose qasjes, në situatat kur një analizë e tregut tregon mungesë të konkurrencës së efektshme ...”* Në linjë me këtë, Autoriteti e ka parasysh që me rastin e imponimit të detyrimeve, të ketë në konsideratë të drejtën e operatorit për një normë të arsyeshme të kthimit të investimit. Mekanizmi i mbulimit të kostos dhe/ose metodologjia e caktimit të çmimit që janë të detyrueshme duhet të përkrahin efikasitetin dhe konkurrencën afatgjate, dhe të rrisin përfitimet e konsumatorit.

*Në lidhje me këtë, Autoriteti mund t’i marrë parasysh çmimet në tregjet konkurruese të krahasueshme.”*

ARKEP është e obliguar për të vendosur një metodologji për të llogaritur shpenzimet që do të promovonin efikasitet dhe konkurrencë afatgjate dhe do të ngrite në maksimum përfitimet e përdoruesve. Me qëllim të përcaktimit të metodologjisë së duhur të llogaritjes së kostos së shërbimeve të rregulluara janë marrë parasysh:

Komisioni Evropian në Rekomandimin më të fundit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit (*Rekomandimi i Komisionit Evropian i datës 7 Maj 2009 mbi trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe Mobile në BE (2009/396/EC)*) i referohet kostos së vetme referente për të arritur simetri të tarifave të terminimit të thirrjeve mobile ndërmjet MNO-ve. Sipas rekomandimit , MTR-të përcaktohen sipas kostos së operatorit efikas (dmth autoriteti duhet të përcaktojë dhe llogarisë koston e operatorit efikas). Vlerësimi i kostove efikase të bazohet në kostot tanishme dhe përdorimin kostove afatgjate inkrementale sipas metodologjisë së ashtu quajturës nga poshtë-lart (“bottom-up”) LRIC i pastër;


Kjo metodologji është një detyrim mjaft progresiv (dhe trajtohet si ndryshim i rëndësishëm edhe nga pikëpamja e praktikave ekzistuese rregullatore të BE-së), e cila merr parasysh vetëm kostot shtesë që lindin për shkak të trafikut të terminimit. Kjo do të thotë se shpenzimet e përbashkëta nuk janë të alokuara për shërbimet e terminimit, prandaj pjese e madhe e shpenzimeve të mbulueshmërisë (që zakonisht përbëjnë rreth 60 % të shpenzimeve totale) nuk janë të përfshira në kostot e terminimit të thirrjes mobile. Shumica e vendeve të BE-së dhe disa nga vendet e Regjionit tash e një kohë janë duke zbatuar këtë metodologji dhe rezultatet aktuale tregojnë se MTR bazuar në LRIC të Pastër janë rreth 0.943155 eurocent / min. Lista e shteteve që kanë implemetuar LRIC të pastër është dhënë në tabelën nr 2.

Rekomandimi i KE-së e elaboron për më shumë edhe teknologjitë që modelohen. Ai rekomandon se në gjeneratën e ardhshme (NGN) “core” dhe kombinimin 2G/3G në qasjen pa tela “wireless”, si teknologjitë më të efektshme të aplikuara.

Gjithashtu në këtë rekomandim shtjellohen edhe rastet e Rregullatorëve Nacional me burime të kufizuara, të cilët në rrethana të tilla nuk janë në gjendje të implemetojnë metodologjinë e rekomanduar. Bazuar në këtë rekomandim, nëse këta rregullatorë janë gjendje të demonstrojnë se përveç metodologjisë BU- LRIC i bazuar në rezultatet e kostove aktuale, ajo mund të konsiderojë vendosjen e çmimeve të përkohshme në bazë të metodologjive tjera (p.sh. Benchmarking) e cila jep rezultate në përputhje me këtë rekomandim dhe gjeneron rezultate efikase në përputhje me ato në një treg konkurrues. Çdo rezultat i tillë që del nga aplikimi i metodologjive alternative nuk duhet të tejkalojë mesataren e MTR të vendosura nga Rregullatorët të cilët zbatojnë metodologjinë e rekomanduar.

### **Ecuria e rregullimit të MTR në Kosovë**

- *Niveli i tarifave të terminimit në rrjetet Mobile ka qene objekt rregullimi nga ARKEP (ish ART) në kuadër të procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.*
- *Fillimisht me vendimin nr prot 276/07 i datës 12 dhjetor 2007 Bordi i ARKEP (ish ART) ka përcaktuar nivelin e tarifave me një asimetri prej 1.89*
- *Me vendimin nr. 33 nr.prot. 89/1/10 i datës 12 dhjetor 2010 percaktimi i tarifave per terminimin re thirrjeve ne rrejtin mobil me*
- *Me vendimin nr 13 nr prot 30/1/10 është eliminuar asimetria ne tarifat e terminimit të thirrjeve, mobile në mes të operatorit VALA dhe IPKO,*
- *Me vendimi nr. 271 i datës 30/10/2012 është përcaktuar tarifa e termiminimit me një shkallë zvogëlimi (glide path)*
- *Përcaktimi i këtyre tarifave është kryer duke përdorur krahasimin e nivelit mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE.*
- *Në figurën 1 janë dhënë tarifat e terminimit të thirrjeve mobile në Kosovë në periudhën korrik 2008 - janar 2014.*



**FIGURA 1): Shkalla e Zvogëlimit të Tarifave të Terminimit të Thirrjeve Mobile në Kosovë 2008-2014**

Nga të dhënat e paraqitura në figurë vërehet se mesatarja e thjeshtë e terminimeve mobile në Kosovë nga data 12 dhjetor 2007 deri më tani është zvogëluar me një ritëm të kënaqshëm, e që në vitin 2007 (fillim të vitit 2008) ka qenë nën mesataren e shteteve të BE-së.

Me vendimin nr.271 është bazuar në metodologjinë krahasimore janë përcaktuar MTR për një periudhë prej nëntorit 2012 deri në Janar 2014 (*Glide Path*) dhe që nga ajo kohë MTR nuk ka pas ndryshime. Rrjedhimisht MTR në Kosovë është dashur të përcjellin trendin renës të MTR në vendet e rajonit respektivisht të Berec-ut.

#### **Tarifat mesatare e MTR në vendet e BE sipas BEREC**


Për sa i përket nivelit të tarifave mesatare të aplikuara në vendet e BE dhe në rajon, ARKEP ka grumbulluar informacion duk iu referuar burimeve të mëposhtme:

- Të dhënat e publikuara nga BEREC
- Tarifa mesatare e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër - Të dhëna nga data baza e Cullen International në lidhje me tarifrat e MTR dhe aplikimin e metodologjisë LRIC të pastër.

BEREC kryen publikime periodike të tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile. Publikimet bëhen çdo gjashtë muaj dhe publikimi i fundit është në dhjetor të vitit 2015, i cili paraqet të dhënat për muajin Korrik 2015. Në këtë listë përfshihen 28 vendet anëtare të BE plus 8 vende të tjera evropiane, përfshirë disa vende me status kandidat për anëtar në BE. Në figurën në vijim (fig.2) është paraqitur shkalla e zvogëlimit të tarifave të terminimit në shtetet evropiane<sup>1</sup>, nga data 1


<sup>1</sup> Burimi: <http://www.berec.europa.eu/>

janar 2006 deri me 1 korrik 2015<sup>2</sup>.



**FIGURA 2): Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave të terminimit në rrjetet mobile 2006-2015 (euro/minute)**

Nga të dhënat e paraqitura në figurë vërehet se tarifat e MTR në vendet e BE vazhdimisht janë në janë në rënie, megjithatë në kohën e fundit (janar 2013-korrik 2015) rëniet janë më të lehta.



**FIGURA 3: Tarifat mesatare të terminimit sipas vendeve në janar dhe korrik 2015,**

Sipas të dhënave të mësipërme tarifa mesatare e thjeshtë për 36 vendet e listuara në janar 2015 është 1.55 Eurocent/minutë dhe tarifa mesatare e ponderuar 1.23 eurocent/minutë, ndërsa këto

<sup>2</sup> Mesatarja e thjeshtë (ang. 'Simple average')

tarifa në korrik kanë shënuar një rënie të lehtë në 1.5161€/min përkatësisht 1.2176 €/min.

### Tarifa mesatare e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër

Në tabelë nr 1 janë dhënë tarifat për MTR për 36 vendet që ka publikuar BEREC në raportin e 1 janar 2015, si dhe informacion për vendet që kanë aplikuar LRIC deri në këtë datë dhe ato që kanë marrë vendime/propozuar për aplikim gjatë viti 2015.

**Tabela 1: Tarifat e MTR dhe modeli i aplikuar Janar 2015**

Shteti	Janar 2015	Korrik 2015	Modeli i aplikuar
AT	0.80	0.8049	Pure BU LRIC
BE	1.18	1.1800	Pure BU LRIC
BG	0.97	0.9715	Pure BU LRIC
CH	5.69	6.5723	Commercial Negotiations
CY	1.73	1.7610	Benchmark or TD
CZ	0.98	0.9862	Pure BU LRIC
DE	1.72	1.7200	BU LRAIC +
DK	0.81	0.8066	Pure BU LRIC
EE	1.10	1.0000	Benchmark
EL	1.10	1.1030	Pure BU LRIC
ES	1.09	1.09	Pure BU LRIC
FI	1.87	1.87	FDC
FR	0.78	0.78	Pure BU LRIC
HR	0.82	0.83	Pure BU LRIC
HU	2.29	0.55	Pure BU LRIC
IE	2.60	2.60	Other
IS	0.99	1.02	Benchmark
IT	0.96	0.98	Pure BU LRIC
LI	6.17	7.14	Benchmark
LT	1.04	1.04	Benchmark
LU	0.98	0.97	Pure BU LRIC
LV	1.05	1.05	Benchmark
ME	1.90	1.90	HCA FDC
MK	1.46	1.46	BU LRAIC +
MT	0.40	0.40	Pure BU LRIC
NL	1.86	1.86	BU LRAIC +
NO	1.77	0.96	BU LRAIC

<b>PL</b>	1.02	1.04	Pure BU LRIC
<b>PT</b>	1.27	1.27	Pure BU LRIC
<b>RO</b>	0.96	0.96	Pure BU LRIC
<b>RS</b>	2.85	2.84	Benchmark
<b>SE</b>	0.88	0.81	Pure BU LRIC
<b>SI</b>	1.14	1.14	Pure BU LRIC
<b>SK</b>	1.23	1.22	Pure BU LRIC
<b>TR</b>	0.93	0.87	BU LRAIC+
<b>UK</b>	1.07	0.94	Pure BU LRIC
Average(S)	<b>1.55</b>	<b>1.51</b>	
Average (W)	<b>1.23</b>	<b>1.21</b>	
Average EU 27(S)		<b>1.1347</b>	
Average EU 27 (W)		<b>1.1408</b>	

**Tabela 2: Tarifatat mesatare të MTR sipas modelit BU LRIC i Pastër i aplikuar**

Shteti	Janar 2015	Korrik 2015
AT	0.8049	0.8049
BE	1.18	1.1800
BG	0.9715	0.9710
CZ	0.9772	0.9862
DK	0.8071	0.8066
EL	1.103	1.1030
ES	1.09	1.0900
FR	0.78	0.7800
HR	0.8219	0.831
HU	2.2883	0.5586
IT	0.96	0.9800
LU	0.98	0.9700
MT	0.4045	0.4015
PL	1.0187	1.0493
PT	1.27	1.2700
RO	0.96	0.960
SE	0.879	0.8140
SI	1.14	1.14
SK	1.226	1.226
UK	1.0708	0.941
Average(S)	1.036645	0.943155

ARKEP ka përditësuar informacionin e marrë për aplikimin e LRIC të pastër në tabelën e mësipërme. Përditësimi është bërë me informacionin e publikuar nga Cullen International në Nga të dhënat në tabelën e mësipërme vërejmë se:

- në vitin 2015 janë 20 vende që kanë aplikuar tarifatat e terminimit mobil bazuar në LRIC të pastër, dhe vlera mesatare është 1.036 eurocent/minutë.
- tarifa mestare e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër në 2015 ka një ndryshim shumë të vogël në eurocent.

Ndër 20 vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër është edhe Kroacia e cila ka vendosur që më 1 Janar 2015 tarifa e terminimit në 0.83 eurocent/minutë, nga 2.55 eurocent/minutë në Korrik 2013.

Turqia nuk është përfshirë në listën e vendeve që kanë aplikuar apo planifikuar për LRIC të

pastër, pasi nuk ka informacion të tillë, por vlera prej 0.93 eurocent/minutë në janar 2015 është shumë e përafërt me mesataren e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër.

Gjithashtu vlen të theksohet se disa vende anëtare të BEREC bëjnë rregullimin e tarifave të MTR sipas rajonit gjeografik të origjinimit të thirrjeve, pra disa aplikojnë rregullimin e tarifave për të gjithë trafikun pa marr parasysh se prej nga origjinohet trafiku, disa vete për trafikun nga zona ekonomike evropiane, ndërsa Maqedonia, Malta dhe Turqia aplikojnë rregullimin e tarifave vete për trafikun me origjinë kombëtare.

Application of regulated MTRs according to geographic region of call origination (Cullen research)



**FIGURA 4** Aplikimi i Rregullimit të MTR sipas regjioneve gjeografike të origjinimit të thirrjeve

### Përmbledhje e tarifave mesatare (benchmark)

Në tabelën e mëposhtëm është paraqit një përmbledhje e tarifave mesatare të krahasuara (benchmark).

**Tabela 3: Vlerat mesatare të MTR (benchmark)**

Burimi: BEREC, & Cullen International

BEREC MES 36 (28 Anëtare të BE +8)	Korrik -14	Janar 2015	Korrik -2015
e thjeshtë	1.688	1.55	1.5161
e ponderuar	1.233	1.23	1.2176
BEREC MES. 28 Anëtare të			



BE		
	e thjeshtë	1.1347
	e ponderuar	1.1408
Mesatare 'Pure' LRIC-2015	1.037	0.943

Nga tabela mund të vërehet se:

- Tarifa mesatare është e thjeshtë e 36 vendet anëtare të BEREC (që përfshin edhe vende të rajonit) më datë 1 Korrik 2015 është 1.5161 ndërsa mesatarja e ponderuar është 1.2176 eurocent/min;
- Tarifa mesatare e thjeshtë e 28 vendeve anëtare të BE në 1 korrik 2015 është 1.347eurocent/minutë, ndërsa ajo e ponderuar është 1.1408 eurocent/min;
- Tarifat mesatare në 28 vendet e BE dhe 34 vendet e referuara nga BEREC kanë pasur rënie të konsiderueshme në 2015 në raport me 2014, dhe kjo për shkak të rritjes së numrit të vendeve me LRIC të pastër;
- Tarifa mesatare e terminimit e 20 vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër në Janar të vitit 2015 është 1.037 eurocent/min derisa në korrik të viti 2015 kjo tarifë është ulur në 0.943 eurocent/min;

### Përcaktimi i tarifave të MTR së në Kosovë

Siç është theksuar në me lart bazuar në neni 40 të LKE *Autoriteti mund t'ua imponojë ndërmarrësve që kanë FNT në një treg relevant detyrime për mbulimin e kostos dhe kontrollimin e çmimit, duke përfshirë detyrimet për çmimet e bazuara në kosto dhe detyrimet lidhur me sistemet e llogaritjes së kostos, për ofrimin e llojeve specifike të interkoneksionit ...*. Metoda më e mirë është aplikimi i rregullimit të tarifave të terminimit duke iu referuar rekomandimit të KE të datës 7 Maj 2009.

Rekomandimi në pikën 12 të tij trajton rastin e vendeve me kapacitete dhe kohë të kufizuar për ndërtimin e modelit BU LRIC të pastër, duke rekomanduar që këto vende të aplikojnë metoda alternative (si benchmark) por rezultatet e tyre nuk duhet të jenë më të mëdha se tarifa mesatare e terminimit e vendosur nga Autoritetet Rregullatore që kanë aplikuar metodologjinë e LRIC të pastër.

Duke iu referuar rekomandimit, ARKEP me qëllim të aplikimit të tij për tarifën e terminimit në rrjetet mobile, mund të ndërtojë një model 'LRIC të pastër' ose të përdorë nivelin benchmark të vendeve që e kanë aplikuar modele LRIC për përcaktimin e tarifave të terminimit në rrjetet mobile (sipas rekomandimit të KE).

Në përgjithësi, ekzistojnë metodologji të ndryshme për llogaritjen e një çmimi të bazuar në metodën krahasimore, në veçanti:

- Duke marrë çmimin e tretë më të ulët - kjo metodologji është aplikuar bazuar në Rekomandimin e Komisionit Evropian (tutje referuar si - KE) të datës 08 Janar 1998 mbi interkoneksionin në një treg të liberalizuar të telekomunikacionit (Ref. Pjesa 1 - çmimi i interkoneksionit; 98/195/EC) dhe ndryshimet e mëposhtme;
- Duke marrë mesataret e çmimeve të vendeve të ndryshme;
- Duke zgjedhur si mostër shtetet, të cilat kanë kushte, përkatësisht karakteristika të ngjashme me situatën dhe kushtet e aplikuar në Republikën e Kosovës;
- Zgjidhje tjera të mundshme/aplikueshme.

Duke marrë parasysh gjendjen aktuale sa i përket çmimeve të shërbimeve për tregjet e rregulluara në Kosovë, DKE konsideron se çmimi i tretë më i ulët nuk është një referencë e përshtatshme në këtë moment (pasi që ARKEP ende nuk ka informata të kostos sa i përket çmimeve të rregulluara). Po ashtu është vështirë të zgjedhën shtetet mostër që kanë karakteristika të krahasueshme (dendësia e popullsisë, terreni, zhvillimi ekonomik, etj.) dhe në të njëjtën kohë kanë çmime më të larta apo më të ulëta të shërbimeve sa kostoja.

Prandaj, mesatarja e thjesht e çmimeve të shërbimeve të vendeve të ndryshme evropiane, rezulton të jetë si më e përshtatshme në këtë fazë.

Qëllimi kryesor i përdorimit të metodës krahasimore është për të marrë një vlerësim të përafërt të kostos, prandaj zgjidhja më e mirë do të ishte që krahasimi të bëhet duke u bazuar në çmimet e shteteve, të cilat aplikojnë çmime të orientuara në kosto.

Siç u tha më lart, ARKEP është e mendimit se tani për tani mënyra më efikase dhe më e mirë do të ishte përcaktimi i nivelit të MTR duke iu referuar metodologjisë krahasimore të nivelit mesatar të MTR në vendet që kanë tarifa të orientuara në kosto, përkatësisht që kanë implementuar rekomandimin e KE lidhur me llogaritjen e tarifave duke aplikuar modelin LRIC (vende anëtare të BE dhe të rajonit). Rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) është një praktikë e ndjekur nga ARKEP edhe më parë si dhe një praktikë e cila ka dhënë rezultate të mira.

Në përcaktimin e tarifave, ARKEP mendon se është e nevojshme që krahas nivelit mesatar të MTR në vendet e BE dhe rajonit që kanë aplikuar metodologjin LRIC, të marrë në konsideratë edhe kushtet aktuale dhe pritshmëritë për zhvillimin e tregut në Kosovë, me qëllim të realizimit të objektivave rregullatore për rritjen e konkurrencës efektive në këtë treg dhe realizimin e objektivit final të maksimizimit të përfitimeve të përdoruesve fundorë.

Andaj , duke marr parasysh:

- specifikat e tregut në vendin tonë;
- faktin se që nga janari 2014 nuk është bere zbritje e tarifave të MTR;
- Mesatarja e MTR të vendeve të BE-së dhe vendeve tjera rajonale sipas datës 01 korriku 2015 është afërsisht 1.51 euro/min;
- Shkalla mesatare e zvogëlimit të MTR ne vendet e BE-se (duke përfshirë edhe disa vende rajonale të publikuara ne raportet e BEREC-ut) që nga data 01 janar 2014 - korrik 2015;
- Rregulloren 2015/2352 të 16 dhjetorit 2015 mbi përcaktimin e mesatares se ponderuar maksimale të tarifave të terminimit në rrejtët mobile në të gjithë Unionin.

## KONKLUZION

ARKEP konsideron që tarifat aktuale për MTR të ulen në mënyrë të përshkallëzuar dhe të jenë sipas niveleve dhe afateve kohore të dhëna në figurën e mësipërme, përkatësisht:

- Tarifat e MTR të zvogëlohet/ulet gradualisht në 4 faza të ndërmjetme dhe atë 1/01/2017 deri më 01/07/2018, respektivisht tarifa në 01 Janar 2017 do të zbret në 1.74 euro cent ose një zbritje prej 24.3% ndërsa në Korrik 2018 në 1.146;
- Zvoglimi i tarifave të MTR nga 01 Korriku 2017 do të jetë në shkallën prej 13%.




FIGURA 5. Krahasimi i tarifave të MTR në vendet e BEREC-ut dhe Kosovës